



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

C-IV-14-5812

Ankuesi

Sh. H, Kaçanik.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me 19 shkurt 2020, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar dhe VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI042-4155, i datës 18 korrik 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 11 gusht 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. GJI042-4155, të datës 18 korrik 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilin ka kërkuar pronësi të aksioneve në shumën e paspecifikuar, nga NSH PMN “Sh”. Ankuesi ka pohuar se Ndërmarrja Shoqërore për prodhimin e materialit ndërtimor “Sharr” Çimentorja, me seli në H.. , më datën 12 qershor 1991 e ka bërë ndryshimin e statusit të kësaj ndërmarrje, ashtu që në bazë të aktvendimit të plotfuqishëm FI878/91 të datës 12 qershor 1991, Gjykata e Lartë Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, ka pruar aktvendim mbi ndryshimin statusor të kësaj ndërmarrje dhe e ka bërë transformimin e kësaj ndërmarrje, prej ndërmarrjes shoqërore, në ndërmarrje të shoqërisë aksionare. Po ashtu ankuesi ka pohuar se punëtorët kërkojnë drejtësi

nga Dhoma e Posaçme, që ti anulojë të gjitha kërkesat dhe aktvendimet e AL-së dhe AKP-së ndaj punëtorëve të pa mbrojtur nga askush. Ankuesi në mënyrë të përgjithësuar i ka parashtruar pretendimet e tij si dhe ka kundërshtuar procesin e privatizimit të NSH-së në fjalë, si antiligjor. Në mbështetje të ankesës si provë ka dorëzuar vendimin e kundërshtuar të AL-së, GJI042-4155 të datës 18 korrik 2014.

Me 30 janar 2020, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje, në të cilën ka pohuar se AL-ja ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe zbatim të saktë të dispozitave ligjore. Po ashtu e paditura ka pohuar se sipas rezolutës për Përcaktimin e Statusit Juridik të NSH-së (RPS/SDR) nr. 0425 i datës 26 shtator 2005, Bordi i Drejtorëve të AKP-së përcaktoi statusin e NSH “Sharr” si një ndërmarrje shoqërore në përputhje me nenin 5 të Ligjit nr. 04/L-034 dhe jo si shoqëri aksionare andaj si e tillë ndërmarrja bie nën autoritetin administrativ ekskluziv të AKP-së. Sipas të paditurës, ankuesi në asnjë moment nuk ka arritur të vërtetojë të kundërtën, pra se NSH-ja është shoqëri aksionare si pasojë e transformimit të rregullt.

Arsyvetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në pajtim me nenet 2.4 dhe 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata vlerëson se objekt kontesti i kësaj çështje është vetëm vendimi i kundërshtuar i AL nr. GJI042-4155 i datës 18 korrik 2014 lidhur me kërkesën për pronësi të aksioneve. Ankuesi e ka kundërshtuar vendimin në fjalë dhe të njëjtin e ka bashkangjitur në ankesën e tij. Pretendimet tjera të ankuesit të ngritura në përgjigjen në ankesë dhe pretendimet tjera përgjithësuese në lidhje me procesin e privatizimit të NSH-së, nuk janë objekt i vendimit të kundërshtuar dhe në mungesë të dëshmive mbeten të pashqyrtuara.

Gjykata gjithashtu konstaton se nuk ka kurrfarë dëshmi tjera shtesë në këtë dosje të lëndës siç ankuesi pretendon në përgjigjen e tij në mbrojtje në këtë rast dhe në raste tjera andaj edhe pohimi i tij se të gjitha dëshmitë dhe provat në lidhje me pretendimet e tij rreth statusit të ndërmarrjes gjenden në dosjen e lëndës, është i pasaktë.

Sa i përket bazueshmërisë së ankesës gjykata pasi ka shqyrtuar në tërësi pretendimet e palëve, gjen se çështje e vetme kontestuese mbetet procesi i transformimit përkatësisht ndryshimit të statusit të ndërmarrjes nga Ndërmarrje Shoqërore në Shoqëri Aksionare.

Dëshmitë e përmendura nga ankuesi në ankesë, e të cilat nuk janë bashkangjitur si provë, nuk janë relevante në lidhje me ndryshimin e statusit të NSH-së, pasi ato përbëjnë vetëm fillimin e procedurës së ndryshimit të statusit të NSH-së. Akti i thjeshtë i regjistrimit të ndërmarrjes si SHA në Gjykatën Ekonomike të Qarkut dhe vendimi i Këshillit të Punëtorëve i datës 28 maj 1991 për lëshimin e aksioneve interne vlerësuar qoftë ndaras apo së bashku, nuk nënkuptojnë përmbylljen e procesit të ndryshimit të statusit të ndërmarrjes nga NSH në SHA.

Sipas nenit 36.2 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme (Ligji nr. 04/L-033), pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese). Me fjalë të tjera, kushto që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*). Në këtë rast ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon përmbylljen e procesit të ndryshimit të statusit të NSH-së, me përjashtim të lartcekurave të cilave vetëm ju ka referuar në ankesë, por nuk janë dorëzuar në gjykatë si provë. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në pronësi të aksioneve në shumën të pa specifikuar nga NSH PMN Sh.. nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Për më tepër, e paditura në mbrojtjen e saj ka pohuar se, sipas Rezolutës për përcaktimin e Statusit Juridik të NSH-së (RPS/SDR) nr. 0425, datë 26 shtator 2005, Bordi i Drejtorëve të AKP-së përcaktoi statusin e NSH Sharr si një ndërmarrje shoqërore në përputhje me nenin 5 të Ligjit nr. 04/L-034 dhe jo si shoqëri aksionare, e që si NSH bie nën autoritetin administrativ të AKP-së. Në kuadër të kësaj gjykata nuk gjen asnjë bazë për të kontestuar tërë procesin e përcaktimit të statusit të ndërmarrjes në bazë të një rasti individual apo kërkesë për pronësinë e aksioneve nga NSH PMN “Sh..” (në likuidim), kundër vendimit të kundërshtuar të Autoriteti të Likuidimit.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksa gjyqësore, pasi që vlera e kontestit konsiderohet së është nën 1,000.00 €.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r e
Hajrie Shala

